



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:205790
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05700208

E.nr.1133/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës F.Xh. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson Av Dalip Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizaj- Drejtoria Komunale e Arsimit për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1133/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorës.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1133/23, të datës 24.08.2023 e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorës, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:205790 të dt.22.06.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 09.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 540.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1195/23 më datë 15.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi